



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.1021/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Labinot Ademi, përfaqësues i anëtarëve të kandidatëve për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. PRANOHET** si i bazuar apeli i apelin e Labinot Ademi, përfaqësues i anëtarëve të kandidatëve për Kuvendin Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017,

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në Vendvotimet nr.1924E/02e, 1924e/02R, 1931e/01R, 1906e/12R, 1906e/09R, 1919e/05R, 1913e/06R, 1903e/01R, 1304e/07R, 1906e/16R, 1906e/18R, 1912e/04R, 1960e/003, 1927e/05R, 1922e/02R, 1921e/03E, 1921e/03R, 1920x/04R, 1920e/04R, 1920e/03R, 1919x/02R, 1903e/05R, 1906e/07R, 1921e/02R, 1926e/03R, 1940e/02R, 1917e/02R, 1912e/02R, 1915e/02R, 1905e/03R, 1907e/03R, 1907e/03R, 1911e/03R, 1915e/03R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 10.11.2017, Labinot Ademi, përfaqësues i kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal, Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me të cilën ka pretenduar se rezultatet e zgjedhjeve janë të manipuluar dhe se në listat e publikuara nga KQZ-ja, nuk e pasqyrojnë numrin e votave të

fituara nga kandidatet në mënyrë individuale dhe kjo dëshmohet edhe nga raportet e komisionerëve dhe vëzhguesve të PDK-së dega në Prishtinë. Gjatë analizimit të procesit të numërimit kanë vërejtur se ekzistojnë formularët të panënshkruar nga personat përgjegjës dhe se dyshojnë se në qendrat e numërimit ju janë marrë votat e kandidatëve të PDK-së.

Me këtë rast kandidatet për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik PDK kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimet që dyshohet se ka parregullsi me numër: 1924E/02e, 1924e/02R, 1931e/01R, 1906e/12R, 1906e/09R, 1919e/05R, 1913e/06R, 1903e/01R, 1304e/07R, 1906e/16R, 1906e/18R, 1912e/04R, 1960e/003, 1927e/05R, 1922e/02R, 1921e/03E, 1921e/03R, 1920x/04R, 1920e/04R, 1920e/03R, 1919x/02R, 1903e/05R, 1906e/07R, 1921e/02R, 1926e/03R, 1940e/02R, 1917e/02R, 1912e/02R, 1915e/02R, 1905e/03R, 1907e/03R, 1907e/03R, 1911e/03R, 1915e/03R.

Apelit ia ka bashkangjitur listën e nënshkruar nga kandidatet për anëtar te Kuvendit Komunal të Prishtinës, formularët e të gjitha vendvotimeve me të cilën pretendojnë se ka parregullsi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze. Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.A.nr.1021/2017 me datë 13.11.2017

**Kryesuese e Panelit**

**Rafet Haxhaj**



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*